



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS

**Drejtuar:** Operatorin ekonomik “NOVA Construction 2012” shpk & “Ante Group” shpk

**Adresa:** Rruga “Kajo Karafili”, Pallati MC Inerte, Tirane, 1001

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” “Ndërtimi i Terminalit Verior të Transportit Publik, Tiranë”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Ndërtimi i Terminalit Verior të Transportit Publik, Tiranë”.

**2. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-41118-09-09-2022**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Fondi limit: 820,177,697.88** (tetëqind e njëzet milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** me të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2022, miratuar me VKB Nr. 64, datë 12.07.2022 “Për disa ndryshime në VKB Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022 (e ndryshuar)”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 (gjashtë) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 12.10.2022, ora 10:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.129 datë 19.09.2022.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik “DON JURGE” shpk** **NUIS K33005405Q**

Vlera e ofertës: **0** (zero) lekë pa TVSH

- 2. Operatori ekonomik “Edurat Çela”** **NUIS M03806202I**

Vlera e ofertës: **0** (zero) lekë pa TVSH.

- 3. Operatori ekonomik “VEGA” shpk & “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk**

**NUIS K01524006L & NUIS K91326028I**

Vlera e ofertës = **639,717,761.39** (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

- 4. Operatori ekonomik “SALILLARI” shpk** **NUIS J62903125G**

Vlera e ofertës = **674,149,678.35** (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

- 5. Operatori ekonomik “BE - IS” shpk & “ERGI” shpk & “2 T” shpk**

**NUIS K714120003A & NUIS K02727229P & NUIS K01731001M**

Vlera e ofertës = **702,495,116** (shtatëqind e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 6. Operatori ekonomik “ULZA” shpk & “AGRI CONSTRUCTION” shpk**

**NUIS J67902928O & NUIS K01725001F**

Vlera e ofertës = **719,298,544** (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH.

- 7. Operatori ekonomik “METEO”.shpk & “ALBA KONSTRUKSION” shpk**

**NUIS L26310801C & NUIS J61812013R**

Vlera e ofertës = **726,678,384** (shtatëqind e njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

## 8. Operatori ekonomik “NOVA Construction 2012” shpk & “Ante-Group” shpk

NUIS L22404012D & NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = **723,315,114.40** (shtatëqind e njëzet e tre milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e katërbëdhjetë pikë dyzet) lekë pa TVSH.

## 9. Operatori ekonomik “4-AM” shpk

NUIS K92005016L

Vlera e ofertës = **734,177,508.59** (shatëqind e tridhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

## 10. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk & “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk & “PE - VLA - KU” shpk

NUIS K61625001I & NUIS K51423028P & NUIS K61716013M

Vlera e ofertës = **729,790,616.72** (shtatëqind e njëzet e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

### 1. Operatori ekonomik “DON JURGE” shpk

- Operatori Ekonomik **DON JURGE shpk**, nuk ka plotësuar asnjë nga kërkesat e percaktuara ne Dokumentat Standart te Tenderit.

### 2. Operatori ekonomik Eduart Çela

- Operatori Ekonomik **Eduart Çela**, nuk ka plotësuar asnjë nga kërkesat e percaktuara ne Dokumentat Standart te Tenderit.

### 3. Operatori ekonomik “VEGA” shpk & “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk

- Bashkimi i operatoreve ekonomik VEGA & Alko Impex General Construction shpk, nuk plotëson shkronjen b, tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Sigurimi i Ofertes sipas shtojces 3, pasi Formulari i sigurimit te ofertes nuk eshte i rregullt sipas formes ligjore te kerkuar. Formulari i sigurimit te ofertes me nr serial 220606430, date 12.10.2022, eshte leshuar ne emer te operatorit ekonomik Vega shpk, pa specifikuar anetarin tjetër te bashkimit te operatoreve konkretisht Alko Impex General Construction shpk, cka bie ne kundërshtim me VKM 285, date 19.05.2021, neni 88, pika 2, ku citohet se: *“Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë”*

- Bashkimi i operatoreve ekonomik VEGA & Alko Impex General Construction shpk, nuk ploteson shtojcen 7 “Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit” pasi nuk eshte paraqitur ndarja e punimeve ndermjet operatoreve ekonomik sipas marreveshjes se bashkepunimit, sic eshte percaktuar ne dokumente standarte te tenderit, Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit, do të paraqitet: *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit”*.
- Operatori ekonomik Vega Shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit Formularin permbledhes te vetedeklarimit i cili mban daten 10.12.2022 dhe jo ne daten e hapjes se ofertave per kete procedure prokurimi, konkretisht 12.10.2022, cka bie ne kundërshtim me kerkesat e percaktuara ne Shtojcen 7, Kriteret e Pergjithshme te Pranimit, ku percaktohet se “*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës sipas Shtojcës 8*”. Per rrjedhoje operatori ekonomik Vega Shpk nuk ploteson kerkesen sipas germa c, pika 2, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, konkretisht: *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8*.
- Operatori ekonomik Vega Shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8, pjese e te cilit eshte dhe deklarata C “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”. Nga verifikimi i deklarates rezulton se Operatori ekonomik Vega Shpk, nuk ka deklaruar kollonen Targa, Leje qarkullimi, Nr.Shasie, per mjetet ne pronesi te deklaruar ne shtojcen 8, konkretisht mjetet Eskavator me goma dhe Fadroma. Per rrjedhoje operatori ekonomik Vega Shpk nuk ploteson piken 15, Kapaciteti Teknik, te Kritereve te Vecanta te Kualifikimit,
- Operatori ekonomik Vega Shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8, pjese e te cilit eshte dhe deklarata C “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”. Nga verifikimi i deklarates rezulton se Operatori ekonomik Vega Shpk, nuk ka deklaruar kollonen Targa, Leje qarkullimi, Nr.Shasie, per mjetet ne pronesi te deklaruar ne shtojcen 8, konkretisht mjetet Eskavator me goma dhe Fadroma. Per rrjedhoje operatori ekonomik Vega Shpk nuk ploteson piken 15, Kapaciteti Teknik, te Kritereve te Vecanta te Kualifikimit,
- Operatori ekonomik Alko Impex General Construction shpk, nuk permbush kerkesat per plotesimin e Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8, pasi nga verifikimi i deklarates C “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, per mjetet ne pronesi nuk ka deklaruar numrin e Lejes se qarkullimi dhe Nr.Shasie ndersa per mjete e mara me qera nuk ka deklaruar Leje qarkullimi, Nr.Shasie te mjetit, numrin e kontrates se qirase si dhe afatin e kontrates se qirase.

#### 4. Operatori ekonomik “SALILLARI” shpk

- Operatori ekonomik Salillari Shpk nuk permbush kerkesat e pikes 2.3 te Kritereve te Vecanta te Kualifikimit, ku percaktohet se: “*Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pese viteve të fundit*”, pasi nga punet e ngjashme te paraqitura rezulton se: per kontraten me objekt : “*Riparim i shkollës “Dom Nikollë Kacorri” dhe Rindërtimi i Kopshtit*

*Kamez*” me vlerë ndërtimi 138,622,580.25 lekë pa TVSH, **mungon Formulari i Vlerësimit sipas Shtojces 9**, ndërsa për kontratën me objekt *“Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës Milot – Morinë”*, me fazat përkatëse, nuk konsiderohet punë e ngjashme me objektin e prokurimit **” Ndërtimi i Terminalit Verior të Transportit Publik, Tiranë”**.

#### **5. Operatori ekonomik “ULZA” shpk & “AGRI CONSTRUCTION” shpk**

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“ULZA & AGRI CONSTRUCTION” Shpk nuk përmbush kërkesat e percaktuara në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021**, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, ku percaktohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 26.10.2022 ftoi bashkimin e operatoreve ekonomik “Ulza & Agri Construction” Shpk, që të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike brenda datës 27.10.2022, ora 14:00. Në rast se Operatori ekonomik, nuk do të pajtohet me këtë kërkesë, ose nuk do të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar si më lart, oferta Tij do të refuzohet. KVO konstatoi se Operatori ekonomik nuk është pajtuar me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pasi brenda datës 27.10.2022, ora 14:00, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Neni 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vendosi të s’kualifikojë ofertën e bashkimin e operatoreve ekonomik “Ulza & Agri Construction” Shpk.

#### **6. Operatori ekonomik “BE - IS” shpk & “ERGI” shpk & “2 T” shpk**

- Operatori ekonomik “Be IS” Shpk nuk përmbush pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, për përvojën e suksesshme, pasi pas verifikimit të punëve të ngjashme të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se për objektin *“Rindërtimi i njësisë të Banimit në ndërtesa pallat për zonën e re për zhvillim Manzë, objektet A1, A2, B1 dhe B3, njësi banimi në ndërtesa pallat, njësi Administrative Manzë, Bashkia Durrës”*, mungon Çertifikata e marrjes në dorëzim apo Çertifikata e përkohshme të marrjes në dorëzim. Për rrjedhojë nuk plotëson kërkesën për vlerën e kërkuar të punës së ngjashme sipas pikës 2.3, germa a) dhe b) të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

#### **7. Operatori ekonomik “METEO”.shpk & “ALBA KONSTRUKSION” shpk**

- Bashkimi i operatoreve ekonomik “Alba Konstruksion & Mateo” shpk, nuk plotësojnë pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 8, pasi pas verifikimeve rezultoi se nuk është deklaruar 1 (nje) Inxhinier Elektrik.

- Operatori Ekonomik Mateo shpk, nuk ka deklaruar ne shtojcen 8, 1 (nje) Pergjegjesin per sigurine e shendetin ne pune, kerkuar ne DST, pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 6, ku citohet se: Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga autoritetet te akredituara pergjegjese shteterore, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")*.
- Operatori Ekonomik Mateo shpk, nuk ka deklaruar ne shtojcen 8, 1 (nje) ekspert Zjarrefikes, kerkuar ne DST, pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 6, ku citohet se: "Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim" në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim")*. Gjithashtu pas verifikimeve rezultoi se sipas marreveshjes se bashkepunimit OE Mateo shpk, ka marre persiper te kryeje punimet e MNZ, por nuk ka ekspertin zjarrefikes, cka bie ne kundershtrim me DST.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "NOVA Construction 2012" shpk & "Ante-Group" shpk**, me adresë: Rruga "Kajo Karafili", Pallati MC Inerte, Tirane, 1001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **723,315,114.40** (shtatëqind e njëzet e tre milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e katërmëdhjetë pikë dyzet) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".